



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E FINANCEVE
DREJTORIA E PERGJITHSHME E DOGANAVE

UDHEZIM

Nr. 03, date 28.09.2012

“Mbi procedurat e licensimit te perfaqesuesit fiskal”

Me qellim percaktimin e procedurave lidhur me licensimin e perfaqesuesit fiskal ne dogane,

Ne zbatim te neneve 3 dhe 108 te ligjit Nr. 61/2012 date 24.05.2012 "Per Akcizen ne Republikën e Shqiperise" dhe te neneve 2 deri 10 te VKM Nr.612, date 05.09.2012 "Per Dispozitat Zbatuese te ligjit per Akcizat ne Republikën e Shqiperise", Drejtori i Pergjithshem i Doganave,

UDHEZON:

1. Procedurat e licensimit te perfaqesuesit fiskal behet perms testimi me shkrim ne plotesim te kushteve dhe kriterëve te percaktuara nga ligji Nr. 61/2012 date 24.05.2012 “Per Akcizat ne Republikën e Shqiperise”, VKM nr. 612, date 05.09.2012 “Per dispozitat Zbatuese te ligjit per Akcizat ne Republikën e Shqiperise”, si dhe percaktimeve te ketij udhezimi.
2. Drejtoria e pergjithshme e Doganave (DPD) organizon testimin per licensimin e personave qe kerkojne si perfaqesues fiskal. Procedurat e ketij udhezimit do ti nenshtrohen edhe agjente doganore te licensuar sit e tille nga Administrata Doganore dhe qe kerkojne te veprojne edhe si perfaqesues fiskale.
3. Testimi drejtohet nga nje Komision testimi qe emerohet nga drejtori i pergjithshem i doganave dhe kryesohet nga Zv/Drejtori i pergjithshem i Departamentit te Akcizes dhe ka ne perberjen e tij edhe 4 punonjes te Departamentit te Akcizes.
4. Tersimi organizohet 2 ose me shume here ne vit ne varesi te kerkeses per perfitimin e ketij statusi. Drejtori i Pergjithshem i Doganave, cakton ditën e organizimit te testimi per perfaqesuesit fiskal.
5. Shpallja e testimi behet publike, perms njoftimit ne faqen web te administrates doganore www.dogana.gov.al si dhe shpallje ne ambienten e zyrave doganore. Ne njoftimin e publikua/shpallur percaktohen edhe kushtet dhe dokumentacioni qe nevojitet per testim. Njoftimi duhet te permbaje gjithashtu edhe faktin e fundit per aplikim.
6. Komisioni i testimi verifikon dokumtacioni e paraqitur nga aplikanti qe do te konkuroje si perfaqesues fiskal me qellim permbushjen e te gjitha kushteve qe duhet te plotesoje ai, qe konsistojne kryesisht ne plotesimin e kushteve te permendura ne nenin 4 te VKM nr. 612, date 05.09.2012 “Per dispozitat Zbatuese te ligjit per Akcizat ne Republikën e Shqiperise”,
7. Te gjithë kandidatet te cilet kane plotesuar kushtet e legjislacionit ne fuqi dhe jane kualifikuar nga elementet e dosjes i nenshtrohen nje testimi me shkrim mbi njohurite e pergjithshme teorike si dhe zbatimin praktik te legjislacionit te akcizes. Testi pergatitet nga Komisioni i testimi dhe miratohet nga Drejtori i Pergjithshem.

8. Numri maksimal i pikeve eshte 100 pike. Konsiderohet se kajojne testimin personat qe kane fituar me shume se 70 pike.
9. Rezultat behen publike ne ambientet e Drejtorise se Pergjithshme te Doganave.
10. Me qellim regjistrimin e specimentit te firmes dhe nenshkrimit prane Administrates Doganore per identifikimin e veprimeve q do te kryejne si perfaqesuesit fiscal, te gjitha aplanatet fitues, duhet te paraqiten prane perfaqesuesit te Komisionit te testimit, bene dhe krahasimit e nenshkrimit me ane te dokumentit te identifikimit (Karten e Identitetit, Pasaporten).
11. Pas plotesimi te percaktimit te pikes 10 me lart, Drejtori i Pergjithshem i Doganave, leshon licence per te vepruar si perfaqeuse fiscal per kandidatet qe kane fituar piket e nevojshme te provimit. Formatu i licences jepet ne Aneksin 1 te ketij udhezimi. Ne licence shenohet edhe Kodi Fiskal me te cilin pajiset perfaqesuesi fiscal.
12. Pas leshimit te licences nga Drejtori i Pergjithshem i Doganave, DPD kyen veprimet e regjistrimit te sistemit elektronik te dhenave qe lidhen me personin qe do te veprojte si perfaqesues fiscal.
13. Personat e licensuar i nenshtrohen trajnimve mbi persorimin e Sitemit informatik te doganes.
14. Ngarkohet per zbatimin e ketij udhezimi Departamentit i Akcizes.
15. Ky udhezim hyn ne fuqi menjehere.

Flamur GJYMISHKA

DREJTOR I PERGJITHSHEM